

Rregullore e sjelljes seksuale për punonjësit/et humanitarë/e

Ndaj punonjësve/eve humanitarë/e **mund të ndërmerren masa disiplinore – edhe të pushohen nga puna – për sjellje të papranueshme seksuale.** Këto janë rregullat të cilët ata/ato duhet të respektojnë :

- Punonjësit/et humanitarë/e **nuk lejohen të kenë marrëdhënie seksuale me persona nën moshën 18 vjeç, edhe nëse ky veprim është i ligjshëm në vendin e tyre.** Pohimi se nuk e dinin moshën reale të personit nuk është justifikim i vlefshëm.
- Punonjësit/et humanitarë/e **nuk lejohen të paguajnë me para, vend pune, të mira apo shërbime në këmbim të seksit** – përfshirë të mira apo shërbime të cilat synohen t’u jepen njerëzve në nevojë në formën e ndihmës. Ata/ato nuk duhet të bëjnë premtime të këtij lloji të cilat detyrojnë persona të tjerë të pranojnë sjellje të cilat i poshtërojnë ata/ato ose këta të fundit. Këtu përfshihet edhe pagesa ose ofrimi i parave në këmbim të seksit me një punonjëse seksi.
- Punonjësit/et humanitarë/e që mund të kenë ndikim në përcaktimin e personave që do të marrin të mira apo shërbime **nuk duhet të kryejnë marrëdhënie seksuale me personat që mund të marrin këto ndihma.** Nëse e bëjnë këtë, atëherë shkatërrojnë besimin në punë.
- Nëse një punonjës/e humanitar/e është i **shqetësuar apo dyshon** se dikush në organizatën e tij/saj ose në ndonjë organizatë tjetër që jep ndihma mund të jetë duke thyer rregullat humanitare për sa i përket sjelljes seksuale, ai/a **duhet** ta raportojë të dhënë duke ndjekur **procedurat** e vendosura prej agjensisë së tyre.
- Punonjësit/et humanitarë/e **duhet të krijojnë dhe ruajnë** një mjedis pune që parandalon sjelljet seksuale të papranueshme dhe inkurajon stafin të sillen sipas **kodit të tyre të sjelljes. Të gjithë menaxherët/et** janë përgjegjës/e për mbështetjen dhe zhvillimin e sistemeve që ruajnë këtë mjedis.

Rregullat e IASC mbi shfrytëzimin dhe abuzimin seksual mund t’i gjeni këtu :

http://www.pseataaskforce.org/uploads/tools/sixcoreprinciplesrelatingtosea_iasc_english.doc. Versioni në gjuhën e thjeshtuar u zhvillua në bashkëpunim me Ekipin e IASC të ngarkuar me përgjegjësinë kundrejt Popullsive të dëmtuara dhe Mbrojtjen nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual dhe Translators Without Borders (Përkthyes Pa Kufij).